



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 744, datë 13.12.2024

PËR

**SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...}
DHE PËRJASHTIMIN E TIJ NGA PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË NË
GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR DHE NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 136 dhe në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “c”, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, në nenin 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 113 dhe 114, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 58, pika 1, shkronja “b”, dhe 61 të Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “dh”, si dhe në Kreun XI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 293, datë 30.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 500 dhe nr. 501, datë 21.11.2022, si dhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.
2. Skualifikimin e kandidatit z. {...} dhe përjashtimin e tij nga procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e

Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 500, datë 21.11.2022 dhe për ngritjen në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e tij nr. 503, datë 21.11.2022.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër vendimit mund të paraqitet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR